



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjerat/Prodato Received/Delivery	20-03-2023	3	viti god year
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
MPB/SHIC	2826/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.311/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.311/2022 të datës 03.02.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit Nr.148/2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 05.01.2023, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.311/2023 e datës 03.02.2023 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.148/2023 i datës 05.01.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si dhe Akti i Emërimit AE.nr.18/2022 i datës 06.01.2023.

A r s y e t i m

Ankuesja, e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kundër Vendimit Nr.148/2023 për transferim të datës 05.01.2023 të Zv/Drejtoreshës së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokoli:1301/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli, me

datë 22.02.2022 me numër protokoli 3993/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.311/2023 të datës 03.02.2023, me numër protokoli 1301/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.148/2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 05.01.2023; Akt emërimit AE.Nr.18/2022 të ankueses i datës 06.01.2023; Akt emërimit e ankues të datës 12.10.2015; Njoftimin e datës 14.09.2016; Vendimin e Këshillit A.nr.547/2022 të datës 02.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.02.2023; E-mailin e datës 06.03.2023 dërguar nga V.B për Këshillin; Raportin Nr.2778 të Komisionit të Ristrukturimit i datës 30.12.2022; Konkursin e datës 27.12.2022; Ankesën A.nr.547/2022 të datës 20.06.2022, me numër protokoli 3582/2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankueses i datës 12.10.2015 me numër prot:1577; Njoftimin për konfirmimin e aktit të emërimit i datës 14.09.2016; Njoftimin e datës 15.03.2022 me numër prot:841; E-mailin e datës 02.02.2022 dërguar nga Zyra e Sekretarit të MPJD-së për ankuesen dhe stafin e MPJD-së; E-mailin e datës 04.02.2022 dërguar nga Zyra e Sekretarit të MPJD-së për ankuesen dhe stafin e MPJD-së; E-mailin e datës 01.04.2022 dërguar nga V.B; E-mailin e datës 04.04.2022 dërguar nga ankuesja për V.B me njoftimin e bashkëngjitur; CV-në e ankueses; Letër motivimin e ankueses; E-mailin e datës 17.05.2022 dërguar nga ankuesja për V.B; Kërkesën e dërguar përmes e-mailit të datës 23.05.2022 nga ankuesja për SH.L; E-mailin e datës 31.05.2022 dërguar nga A.H për ankuesen; E-mailin e datës 31.05.2022 dërguar nga ankuesja për V.B; E-mailin e datës 27.05.2022 dërguar nga Maliqe Hashani për ankuesen; Lista e të punësuarve në MPJD me renditjen sipas strukturës organizative; E-mailin e datës 23.08.2021 dërguar nga L.H për ankuesen; E-mailin e datës 26.08.2022 dërguar nga ankuesja për L.H; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen i datës 27.01.2021; Formularin për vlerësimin e nëpunësve të shërbimit të jashtëm i vitit 2020 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e nëpunësve të shërbimit të jashtëm i vitit 2021 për ankuesen; kërkesën e këshillit për Përgjigje në ankesë të datës 29.06.2022; Përgjigjen në kërkesë e pranuar me datë 08.07.2022 dhe numër prot:3995/2022; E-mailin e datës 04.07.2022 dërguar nga K.K për Këshillin me shkresat e lëndës; Vendimin e nxjerrë nga DMZP me datë 24.02.2022 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga S.K për V.B; E-mailin e datës 10.03.2022 dërguar nga Sh.L për S.K; Vendimin për miratimin e përkrahimit të detyrave të punës i datës 16.03.2022 me numër prot:870; Shkresën e Komisionit të Ristrukturimit e titulluar Metodologjia e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit për kriteret e vlerësimit; Raporti i punës dhe propozimet e Komisionit për Ristrukturimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 14.04.2022; Raporti i punës dhe propozimet e Komisionit për Ristrukturimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 22.04.2022; Shtojca: II-Formula e Vlerësimit; Vendimin për transferimin e nëpunësit S.U me numër:12/2022 i datës 10.05.2022 i nxjerrë nga DMZP; Çertifikatën e ankueses të datës 01.02.2016; Çertifikatën e ankueses të datës 25.09.2022; Mirënjohjen e datës 26.11.2012; Mirënjohjen e datës 25.03.2008; Mirënjohjen e datës 20.05.2010; Mirënjohjen e datës 01.10.2017; Mirënjohje e datës 08.11.2017; Mirënjohje e periudhës dhjetor 2017; Mirënjohje e datës 06.07.2015; Mirënjohje e datës 19.04.2002; Çertifikatën e datës 04.04.2008; Diplomën e datës 15.08.2003; Diplomën e datës 26.07.2002; Çertifikatën e datës 26.10.1999; Çertifikatën e datës 21.12.2000; Çertifikatën e periudhës maj 2003; Vërtetimin e datës 20.06.2003; Vërtetimi e datës 25.11.2009; Çertifikatën e datës 09.11.2001; Çertifikatën e datës 31.10.1993; Çertifikatën e datës 01.01.2000; Çertifikatën e datës 25.10.2000; Çertifikatën e datës 07.11.2006; Akt Emërim i pozitës Drejtor i Departamentit për Çështje Rajonale i datës 01.11.2011; Aktvendim -

Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës Certifikatë - Java e Albanologjisë 2010; Certifikatë e Bursës - DAD Certifikatë e marrëdhënies së punës - ZKM - 18.07.2008; CV - 2022 e nëpunësit civil S.U; E-mailin e datës 27.07.2022 dërguar nga V.B për Këshillin; Çertifikatën e Doktoratës Lëshuar nga Universiteti i Bremenit në Gjermani; Diplomën e datës 21.01.2011 me numër:82; Diplomën e Doktoratës me numër:2165 të datës 09.06.2021; Diplomën e datës 01.08.2002 me nr.89; Dëshmi - Redaktor në botimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës; Dëshmi e gazetës Rilinda ne vitin 1999; Kontratë e marrëdhënies së punës - MPJ - 17.05.2009-16.05.2012; Kontratë e marrëdhënies së punës në ZKM për periudhën 16.05.2006 - 16.05.2009; Kontratë mbi vepër - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës - 2014; Kontratë mbi vepër - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës 2019; Marrëveshje për transfer të përhershëm MPJ & Agjencia Shtetërore e Arkivit & Dokumente tjera i datës 13.10.2011; Note Verbale - I ngarkuar me punë përkohshëm - Shqipëri në vitin 2016; Provimi i gjuhës gjermane Universiteti i Kasseli Gjermani; Rekomandim për ngritje të gradës Ministër-fuqiptotë A.Z Qershor 2020; Rekomandim për ngritje të gradës Ministër-fuqiptotë D.P Dhjetor 2020; Shkresë Emërimi më shifër ZKM i periudhës kohore 14.01.2003-14.04.2003; Shkresë Emërimi nga ZKM për periudhën 15.04.2003 deri 15.04.2006; Shkresë Emërimi - ZKM - 21.08.2002-21.11.2002; Shkresë Emërimi - ZKM - 22.11.2002-21.08.2003; Vendim për emërim - I ngarkuar me punë i përkohshëm Tiranë, Shqipëri - 05.01.2018; Vendim për kthim nga misioni i datës 15.11.2019; Vendim për lëvizje paralele - Zyrtar i lartë i seksionit për marrëdhënie dy palshe i datës 09.07.2008 ;Vendim për miratim të gradës diplomatike Këshilltar i datës 30.04.2014; Vendim për sistemim të përkohshëm Udhëheqës i Departamentit për Çështje Politike i datës 15.11.2019; Vendim për transfer nga ZKM në MPJ i datës 16.07.2008; Vërtetim - Arkivi Shtetëror i Kosovës - Drejtor i Departamentit të A.Sh. për kohën nga data 01.10.2009 deri 01.11.2011; Vërtetim - Fakulteti i Edukimit në cilësi të Ligjëruesit nga data 10.11.2012-deri më 02.03.2013; Vërtetim - Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit për periudhën nga 18.12.2000 deri 31.12.2002 ; Vërtetim lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit për periudhën nga 18.12.2000 deri 31.12.2002; Vërtetim i lëshuar nga MPJ/Divizioni i Personelit i datës 09.06.2020; Vërtetim i lëshuar nga MPJ/Divizioni i Personelit 09.09.2015 Vërtetim i lëshuar nga MPJ/Divizioni i Personelit i datës 20.07.2009; Vërtetim i MPJ/Divizioni i Personelit që nuk ka të shqiptuar masë disiplinore 23.07.2021; Vërtetim /Rilindja nga data 01.06.1996 deri më 01.10.1999; Vërtetim i lëshuar nga Shkolla e mesme bujqësore "Zeneli Hajdini" /01.09.2000-31.12.2001; Vërtetim i lëshuar nga UBT për nëpunësin S.U; Vlerësimi i L.B ne mbarim te misionit për S.U; Vendimi me shifër 714 DMZP-MPB; Akt Emërim - Udhëheqës i Departamentit për Çështje Politike i datës 18.12.2019; E-mailin e datës 27.07.2022 me numër prot:4335/2022 dërguar nga K.K për Këshillin; Diplomën e ankueses të datës 24.01.2006 me nr:616; Diplomën e datës 15.12.2014 me nr:38/14; E-mailin e Menaxherit të Njësisë së Burimeve njerëzore të MPJD i datës 26.07.2022; Letër interesin e nëpunësit civil S.U; Përshkrimin e detyrave të punës dhe kriterëve për pozitën Drejtor i Departamenti për Diasporë në MPJD; E-mailin e datës 27.07.2022 të Menaxherit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të MPJD.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se e ankueses është e *pabazuar*, sepse:

Nga vlerësimi i provave të lëndës rezulton së më Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe si

rrjedhë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesen së në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se në bazë të Aktit të Emërimit të datës 12.10.2015 me numër protokoll:1517 është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës në pozitën në pozitën: *"Udhëheqëse e Departamentit për Qendrat Kulturore të Diasporës"*, ndërsa sipas Rregullores Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë, respektivisht është përcaktuar pozitë tjetër e titulluar Departamenti për Diasporë. Meqenëse pozita që ka mbajtur ankuesja, ka pësuar ndryshime dhe se për pozitën e Drejtorit të Departamentit për Diasporë, një nëpunës tjetër ka arritur të grumbulli pikë më shumë gjatë vlerësimit sesa ankuesja dhe i njëjti është emëruar, pastaj Komisioni i Ristrukturimit nuk ka mund të emëroj ankuesen në një pozitën të kategorisë së njëjtë brenda ministrisë për arsye se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet e posaçme për pozitën përkatëse, ndërsa me datë 22.04.2022 i ka propozuar Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB që ankuesen ta transferojnë në pozitën: *"Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale"* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Ankuesja e pakënaqur me pozitën në të cilën ishte transferuar kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 20.06.2022. Tutje Këshilli me datë 02.08.2022 ka nxjerr Vendimin A.nr.547/2023 me numër protokoll:4461/2022 duke e kthyer lëndën e ankueses në ri-shqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për faktin se Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë trajtimit të ankesave të tjera ka hasur në një akt administrativ/Vendim me numër:1100/2022 të lëshuar nga Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publik i datës 13.07.2022 dhe e ka administruar në cilësi të provës materiale pasi që përmes këtij vendimi një nëpunës civil tjetër ishte transferuar në pozitën: *"Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal"*, respektivisht bëhet fjalë për pozitën e njëjtë të cilën e ka rekomanduar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ta transferojë ankuesen, mirëpo gjatë kësaj periudhe kohore sa lënda ishte në rishqyrtim pozita në fjalë ishte liruar sërish dhe më pastaj Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit të veçantë Nr.778 të datës 30.12.2022 i ka rekomanduar përsëri Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ta transferojë ankuesen në pozitën *"Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale"*, kurse Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes vendimit të datës 05.01.2023 ka nxjerr Vendimin Nr.148/2023 përmes të cilit ankuesja është sistemuar në pozitën e rekomanduar duke i lëshuar edhe Akt Emërimit AE.Nr.18/2022 të datës 06.01.2022 në pozitën *"Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale"* në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill me datë 03.02.2023 ka mbetur pranë pretendimeve të njëjta ankimore sikurse me rastin e parashtrimit të ankesës A.nr.547/2022 të datës 20.06.2022, me pretendimin se pozita në të cilën është transferuar nëpunësi civil S.U, ka qenë pozitë

për të cilën paraprakisht ka shpreh interes ankuesja sipas njoftimit të datës 04.04.2022 dërguar Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së dhe e njëjta pretendon se Komisioni për Ristrukturim në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil me rastin e mos sistemimit të ankueses në pozitën "Drejtor i Departamentit për Qendrat Kulturore në Diasporë" pasi që e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e kërkuara të pozitës duke kërkuar që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses duke e detyruar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të sistemojë ankuesen në pozitën "Drejtor i Departamentit për Diasporë" si dhe të anulojë Vendimin Nr.148/2023 e Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të datës 05.01.2023 si dhe të anulojë Vendimin Nr.12/2022 e datës 10.05.2022 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik përmes të cilit nëpunësi civil S.U ishte emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Diasporë në kuadër të MPJD-së.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil nenin 14 paragrafi 5 ku përcaktohet se: "5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo rristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriterë: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnime", ndërsa nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni i Ristrukturimit ka ndjekur aspektin procedural dhe ka pasur parasysh kriteret e përcaktuara si në dispozitat e lartcekura të rregullores, ngase për pozitën të cilën ankuesja ka synuar të emërohet "Drejtor i Departamentit për Diasporë" në kuadër të Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kanë qenë katër (4) kandidatë të propozuar apo që kanë shprehur interes për të njëjtën pozitë, ndërsa ankuesja ka arritur të grumbulloi gjithsejtë shtatëdhjetë e katër (74) pikë kundrejt nëpunësit civil S.U i cili ka arritur të grumbullojë më shumë pikë, gjithsejtë tetëdhjetë e gjashtë (86) pikë, cili po ashtu kishte shprehur interes për pozitën në fjalë përmes e-mailit të datës 04.04.2022 drejtuar Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPJD-së, sikurse dëshmohet se i njëjti sipas vendimit të datës 23.06.2014 me numër Ref:441/14 ka gradën diplomatike Ministër Këshilltar në kuadër të Shërbimit të Jashtëm Diplomatik

Nga shkresat e lëndës rezulton se nëpunësi civil S.U është më i kualifikuar profesionalisht sesa ankuesja, gjegjësisht i njëjti sipas Çertifikatës së Doktoratës të datës 16.10.2017 lëshuar nga Universiteti i Bremenit në Gjermani ka fituar titullin akademikë-Gradën Doktor i Drejtësisë; sipas Diplomës së Doktoratës me numër:2165 të datës 09.06.2021 lëshuar nga Universiteti i Tiranës i njëjti ka fituar Gradën Shkencore "Doktor" në Marrëdhënie Ndërkombëtare; sipas Diplomës të datës 21.01.2011 me numër:82 ka mbaruar studimet pasuniversitare në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe ka marr titullin Magjistër i Shkencave Juridike; sipas Diplomës së datës 01.08.2002 me nr.89 ka mbaruar studimet universitare në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Prishtinës dhe ka marr titullin Profesor i Historisë, kurse ankuesja Shyhrete Kastrati sipas Diplomës të datës 24.01.2006 me numër:616 ka mbaruar studimet universitare në Fakultetin Filozofik-Dega Pedagogji në Universitetin e Prishtinës dhe ka marr titullin Profesor i Pedagogjisë dhe sipas Diplomës së datës 15.12.2014 lëshuar nga Kolegji Ilirija e njëjta ka mbaruar studimet pasuniversitare Programi Juridik-Civil dhe ka marr gradën LLM për Juridik-Civil, prandaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit konstatohet fakti se Komisioni i Ristrukturimit ka zbatuar drejtë dispozitat e lartcekura të rregullores sa i përket vlerësimin të kriterëve mbi bazën e të cilave bëhet transferimi i nëpunësve civil me rastin e rristrukturimit të institucionit. Po ashtu është për tu theksuar fakti se sipas Shtojcës II të Raportit të datës 24.04.2022 të Komisionit të Ristrukturimit, del që ankuesja sa i përket dy kriterëve të tjera,

gjegjësisht vjetërsisë në shërbimin civil dhe vlerësimeve të rezultateve në punë është vlerësuar njëjtë sikurse nëpunësi S.U, mirëpo ajo ç'farë e ka bërë diferencën në vlerësimin e gjithmbarshëm janë pikët që janë grumbulluar nga kualifikimet profesionale sikurse përcaktohet me nenin 14 paragrafi 5 nën paragrafi 5.3 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit kishte konstatuar se për pozitat lira të asaj kohe që ishin ekuivalente me pozitën që kishte ushtruar ankuesja në kohën e transferimit fillestar të raportit të datës 22.04.2022 sikurse edhe sipas raportit të dytë të Komisionit të Ristrukturimit i datës 30.12.2022, për pozitat e lira e kërkohen edhe kualifikime të posaçme formale, respektivisht për pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"*, për pozitën Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"*, për pozitën Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze ose gjuhën frënge e në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose gjuhën frënge, ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze ose gjuhën frënge"*, për pozitën Drejtor i Departamentit për Organizatat Ndërkombëtare kërkohet: *"Njohje e ndonjë prej (6) gjuhëve zyrtare të OKB-së, në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhët e lartcekura angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhët e lartcekura"*, për pozitën Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja duhet të dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"*, për pozitën Udhëheqës i Departamentit për Evropë dhe BE kërkohet: *"Njohje e gjuhës angleze, frënge ose gjermane në nivelin B2-C2 (e obliguar). Njohja e këtyre gjuhëve dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze"*, ndërsa sipas shkresave të lëndës respektivisht të dosjes së ankueses të dërguara nga institucioni punëdhënës dhe provave të sjella nga ankuesja, Kolegji ka gjetur se ankuesja nuk ofron një dëshmi të tillë se e njëjta njeh ndonjërin nga gjuhët e huaja të kërkuara për pozitat në fjalë, respektivisht në bazë të CV-së të ankueses vërtetohet fakti se sipas vetë deklaratimit të saj se e njëjta e njeh gjuhën angleze në nivelin elementar A1, dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuara dhe e njëjta nuk mund të transferohet në asnjërin nga këto gjashtë (6) pozita që kanë qenë të lira, pasi që edhe dispozitat ligjore lidhur me transferimin për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit përcaktojnë kërkesat e veçanta formale sikurse në nenin 54 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit"*.

Andaj, Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-*



teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë”, në mbështetje edhe të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me nenin 54 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit konstatoi se transferimi i ankueses me rastin e ristrukturimit të institucionit është zbatuar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, prandaj mbi këtë bazë Vendimi Nr.148/2023 i datës 05.01.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe Akti emërimit AE.Nr.18/2022 i datës 06.01.2023 mbeten në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që sipas konkursit të datës 27.12.2022 për pozitën “Drejtor i Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike Rajonale” në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal ankuesja i plotëson kriteret e parapara për pozitën në të cilën është transferuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.311/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së